

**VENDIM**  
**Nr. 386, datë 27.6.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 37, DATË 18.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 kV GJIRI I LALËZIT, DURRËS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 37, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Tabela e përmendur në pikën 1 zëvendësohet me tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.
  2. Në pikën 3, vlera e përgjithshme e shpronësimit zëvendësohet me 1 296 602 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dy) lekë.
  3. Në pikën 4, vlera e përgjithshme e shpronësimit zëvendësohet me 1 296 602 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dy) lekë.
  4. Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, si më poshtë vijon:  
"4.1 Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.".
  5. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:  
"5. Shpronësimi të fillojë menjëherë.".
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 kV, GJIRI I LALËZIT”, DURREËS, FSHATI KURATEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM

Investitori: OSHEE sh.a.

Çmimi për pasurinë truall sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016.

[illegible]